



Datë: 13.06.2025
Numër Protokolli: 4024/2025

A.nr.780/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.780/2025 të datës 30.04.2025 të parashtruar nga ankuesi B.B, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*transfer*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.06.2025 mori:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.780/2025 e datës 30.04.2025 e parashtruar nga ankuesi B.B.

II. Anullohet Vendimi Nr.336 i datës 18.03.2025 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, dhe **anullohet** pjesa e Raportit të Punës të datës 03.03.2025, nga Numrin rendor 85, në faqen 8-tabela (RISISTEMIMI NË POZITA TË NJËJTA, faqe 3), e që ndërlidhet me procesin e transferimit të ankuesit në pozitën “*Zyrtar për Administrativin e të Dhënave*”, si dhe po ashtu **anullohet** tabela lidhur me të gjitha pozitat e përcaktuara të transferimit “*Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidatëve për Shofer*”, nga faqe 18 deri 24, (LËVIZJA BRENDA KATEGORISË SI PASOJË E RISISTEMIMIT), ndërsa lëndë kthehet **në rishqyrtim** dhe **rivendosje** te organi i njëjtë (Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), për pozitën “*Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidatëve për Shofer*”.

III. Obligohet Komisioni i Ristrukturimit për MMPHI, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, sikurse përcaktohet në pikën **II** të dispozitivit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI-së, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi, të përcaktuar si në pikën **III** të dispozitivit të këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, B.B. (*tani e tutje referuar: ankuesi*), e cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me datë 30.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është protokolluar me numër: 2873/2025 nën shenjën A.nr.780/2025, kundër Vendimit Nr.336 i datës 18.03.2025 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik DMZP/MPB.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa Këshilli më datë 22.05.2025 ka pranuar nga kjo e fundit përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2873/2025 e parashtruar nga ankuesi më datën 30.04.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.36 e datës 18.03.2025; Akt Emërimit e ankuesit të datës 04.09.2011; Certifikatën e ankuesit të datës 14.12.2001; Aktgjykimi a. Nr. 1807/16, i datës 10.10.2018, i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Aktgjykimi A.A. nr.22/2019, i datës 10.10.2018, i Gjykatës së Apelit; Kopje e letërnjoftimit për B.B; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.05.2025, dërguar nga R.K, për V.S; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 7780/2025, të datës 22.05.2025; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Ekzaminer pyetës”; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar për Administrim e të dhënave”; Raportin e punës Nr.191 të Komisionit të Ristrukturimit të MMPHI-së; Diplomën e ankuesit të datës 28.05.2006; Diplomën e ankuesit të datës 21.03.2012; Kontrata e punës së ankuesit B.B, e datës 20.08.2003; Kontrata e punës së ankuesit B.B, e datës 14.12.2002; ; Kontrata e punës së ankuesit B.B, e datës 06.09.2010; ; Kontrata e punës së ankuesit B.B, e datës 27.11.2008; ; Kontrata e punës së ankuesit B.B, e datës 01.12.2006;Kontrata e punës së ankuesit B.B, e datës 01.11.2005; Rekomandimi për përtëritjen e kontratës së punës për ankuesin B.B; ; Kontrata e punës së ankuesit B.B, e datës 01.12.2004; ; Kontrata e punës së ankuesit B.B, e datës 30.10.2009; ; Kontrata e punës së ankuesit B.B, e datës 01.06.2007; Vendimin Nr.2392 të datës 02.12.2024 të DMZP.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit B.B është **e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara në këtë çështje administrative nga palët respektive në procedurë administrative, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, gjegjeshit sipas Akt Emërimit të datës 06.09.2011 (*për kohë të pacaktuar-i përhershëm-karrierës*) i njëjti mbanë pozitën e punës “*Ekzaminer*”, në kuadër të Departamentit/Drejtorinë e Automjeteve-Njësia e Patentë Shoferëve, kurse ndaj të njëjtit Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ka nxjerrë Vendimin me shifër Nr.336 i datës 18.03.2025 përmes të cilit ankuesin e ka transferuar në pozitën “*Zyrtar për Administrimin e të dhënave*” në Departamentin e Patentë Shoferëve dhe Automjeteve-Divizioni për Patentë Shifër në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, respektivisht DMZP-ja, nxjerrjen e vendimit për transfer sipas detyrës zyrtare e ka mbështetur në

Raportin e Punës Nr.191 të datës 03.03.2025 të Komisionit të Ristrukturimit për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se procedura e ristrukturimit dhe lëshimit i aktit të kontestuar të datës 18.03.2025, është përcjellë me shkelje të dispozitave të ligjit për zyrtarët publik, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuara të së drejtës materiale, pasi që aktit në fjalë i mungo mbështetja ligjore mbi të cilën është nxjerrë, arsyetimit i mungon zbatimi i legjislacionit të dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publik, ashtu që organi i punësimit nuk e ka arsyetuara faktin pse janë transferuara në një pozitë tjetër, pasi që pozita të cilën e mbaj sipas akt të emërimit të vitit 2011 Ekzaminer nuk është shuar, respektivisht me rregulloren e re janë 50 pozita të tilla të lira në kuadër të Departamentit për Patentë Shofer, dhe se as gjysma e këtyre vendeve nuk janë plotësuar me akt emërimi, më kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e ankuesit, ta anuloi aktin e kontestuar dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni përgjegjës për ristrukturim.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit administrativ konstatoi se Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 29.03.2024 miratuar Rregulloren (ZKM) Nr.08/2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimit të Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nga konstatohet fakti se pozita e ankuesit “*Ekzaminer*” të cilën e ka mbajtur sipas aktit të emërimit që nga data 06.09.2011 është shuar, ndërsa është përcaktuar apo paraparë një pozitë e re “*Zyrtar i Lartë për Vlerësimin Kandidatëve për Shofer*” në Divizionin e Testimit Teorik dhe Praktik, në kuadër të Departamentit për Patentë Shofer dhe Automjete në MMPHI.

Tutje, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me datë 29.11.2024 përmes Vendimit Nr.2392/2024 ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për MMPHI, në përbërje prej tre (3) anëtarësh, ku njëri prej tyre është nga radhët e DMZP-së-Kryesuese, dhe dy anëtarë të tjerë nga radhët e MMPHI-së.

Në vështrim të pretendimeve të ngritura ankimore nga ankuesi, dhe duke marrë parasysh dispozitat e aplikuara nga ligji material për shërbimin civil, respektivisht nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “*Menaxhimi i marrëdhënies së punës së nëpunëses/it civil, nëpunëses/it të shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it të artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknike dhe mbështetëse, bazohet në parimin e ligjshmërisë, integritetit, meritës, transparencës, profesionalizmit, paanësisë partiake dhe mosdiskriminimit.*”, ndërlidhur me nenin 4 paragraf 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “*Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.*”, Kolegji i Këshillit analizoi dhe mori parasysh edhe Aktgjykimin në Rastin KO79/2023 i datës 24.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me trajtimin e ligjit të pagave, kur nder tjerash Gjykata Kushtetuese çështjen e pagës e ndërlidh ngushtë me vendin e punës, dhe si rrjedhojë edhe me të drejtën e pronës si e drejtë e patjetërsueshme (përgjithësisht rrethanave specifike kur ndjekin qëllim legjitim), shih pikën B. Vlerësimi i Gjykatës (364-372) ndërlidhur me pikën IV. Efektet e Aktgjykimin, (388) ku ndër tjerash përcakton se: “*Në fund, Gjykata vlerëson se është e rëndësishme që të ripërsëritë konstatimet e Aktgjykimin të saj paraprak KO219/19 përkitazi me pagat në sektorin publik, përkatësisht detyrimin e Qeverisë, si propozues i ligjeve dhe Kuvendit, si ligjvënës që përfundimisht miraton ligjet e propozuara nga Qeveria, që gjatë hartimit të legjislacionit që ka të bëjë me pagat në sektorin publik, qoftë përmes një ligji të përgjithshëm ose përmes disa ligjeve të veçanta apo edhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese, të kenë parasysh parimet e barazisë para ligjit dhe trajtimin e barabartë të të*

gjithë personave të drejtat e të cilëve preken nga çfarëdo lloj plotësimi ose ndryshimi ligjor. Qeveria dhe Kuvendi duhet të sigurohen që (i) vlerat kushtetuese për barazi para ligjit dhe mos diskriminim të respektohen në gjithsecilën rrethanë dhe që çdo rregullim ligjor të jetë në përputhje me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së si dhe në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe atë të GJEDNJ-së; dhe (ii) që e drejta e pronës të respektohet në gjithsecilën rrethanë dhe që çdo rregullim ligjor të jetë në përputhje me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe atë të GJEDNJ-së”, e ku ndër tjerash Gjykata Kushtetuese ka ngritë çështje dhe ka krijuar rregulla të pa mohueshme se organet publike në rastin e shprehjes se autoritetit publik në secilin rast duhet të ndjekin qëllim legjitim kur në një mënyrë apo tjetër trajtojnë çështje nga kjo fushë, gjegjësisht veprimet administrative kur në një mënyrë apo tjetër prekin interesa legjitime nga marrëdhënia e punës duhet të ndjekin qëllime legjitime, të respektojnë kuadrin ligjor në fuqi dhe të respektojnë normat dhe frymën kushtetuese, andaj në këtë frymë të normës kushtetuese, referuar si më lartë Kolegji i Këshillit, analizoi këtë procedurë të ristrukturimit mbi bazën e kuadrin ligjor në fuqi dhe akteve nënligjore që trajtojnë çështjet nga fusha e transferimit e nëpunësve civil për shkak ristrukturimit apo shuarjes së institucionit.

Kolegji i Këshillit, në vështrim dhe mbi bazën e konstatimeve të dhëna si më lartë, analizoi aktin e kontestuar nga ankuesi, respektivisht Vendimin Nr.336 të datës 18.03.2024 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, dhe konstatoi se ankuesi përmes të njëjti akt ankuesi është transferuar në pozitën “Zyrtar për Administrimin e të dhënave” në Departamentin e Patentë Shoferëve dhe , Divizioni për Patentë Shofer në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, transfer ky i mbështetur mbi Raportin e Punës Nr.191 të datës 03.03.2025 të Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dh Infrastrukturës. Me qëllim të konstatimit të ligjshmërisë së veprime procedurale dhe materiale të Komisionit të Ristrukturimit të MMPHI-së, Kolegji i Këshillit analizoi Raportin e Punës Nr.191 të datës 03.03.2025 dhe konstatoi se Komisioni i Ristrukturimit, sipas pikës RISISTEMIMI NË POZITA TË NJËJTA, ku ndër tjerash në këtë pjesë të raportit si përfundim përcaktohet se, **citoj:** “...Zyrtarët të cilët kanë kryer rolin dhe funksionin e njëjtë në pozitën paraprake, janë risistemuar pa ndryshime”, ashtu që ankuesi nën numri rendor 78 të tabelës, evidentohet se ka mbajtur pozitën ‘**Ekzaminer**’ kategoria-Profesional, ndërsa rekomandohet për transfer në pozitën “Zyrtar për Administrimin e të Dhënave” kategoria-Profesional 2.

Me qëllim të konstatimit nëse pozita në të cilën është transferuar ankuesi, me pozitën të cilën e ka mbajtur sipas Akt Emërimit të datës 06.09.2011, janë të njëjta, sikurse Komisioni i Ristrukturimit e ka përcaktuar si më lartë, Kolegji i Këshillit analizoi përshkrimin e detyrave të punës për pozitën “**Ekzaminer**”, përshkrim ky i përcjellë në Këshill nga Njësia e Burimeve Njerëzore përmes shkresës së datës 22.05.2025 lidhur me përgjigjen në ankesën me shifër A.nr.779/2025, dhe konstatoi si në vijim: “**Detyrat Kryesore:** Detyra 1- Bëmë vlerësimin e kandidatëve për shofer dhe verifikimin e kushteve (verifikimi i mjetit) të ofruara për vlerësim (70%); Detyra 2- Zbaton dhe përcjellë të arriturat në fushën e testimit të kandidatëve për shofer (10%); Detyra 3- Në bazë të rezultateve të punës propozon masa për përmirësimin e metodave të testimit të kandidatëve për shofer (10%); Detyra 4- Në bazë të rezultateve të punës propozon masa për përmirësimin e metodave të testimit të kandidatëve për shofer (10%); si dhe Detyra 5- kryen detyra shtesë sipas nevojave dhe kërkesave të eprorëve (3%)”, ndërsa si **Qëllim i vendit të punës** përcaktohet: “Kryen Vlerësimin e Kandidatëve për shofer”, dhe po ashtu Kolegji i Këshillit analizoi edhe përshkrimin e detyrave të punës për pozitën në të cilën ankuesi është transferuar “Zyrtar për Administrimin e të Dhënave” dhe konstatoi si në vijim: “**Detyrat Kryesore:** 1. Pranimi dhe kontrollimi i dokumenteve të kandidatëve për paraqitjen e provimit teorik dhe praktik; 2. Lëshimi i fletëpagesave për paraqitjen e provimit për kategorinë e

*caktuar nga pjesa teorike dhe praktike; 3. Konfirmimi i fletëpagesës për paraqitjen e provimit; 4. Caktimi i terminit për mbajtjen e provimit nga pjesa teorike dhe praktike; 5. Regjistrimi i kandidatëve në programin elektronik- E-testin; 6. Regjistrimi i të dhënave të kandidatit në programin elektronik; 7. Përgatitja dhe klasifikimi i të hyrave brenda ZRPSH-t dhe raportimi të zytari i Departamentit; 8. Përgatitja e shpenzimeve dhe përcjellja tek organet përkatëse të Ministrisë; 9. Arkivimi i dokumentacionit të kandidatëve të cilët kanë përfunduar provimin në tërësi për patentë shofer; 10. Përgatitja e Raporteve; 11. Përgatitja dhe shtypja e fletëpagesës për paraqitjen e provimit për shoferë; 12. Kryen dhe detyra të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi” ndërsa si **Qëllim i vendit të punës** përcaktohet: “Të sigurojë mbledhjen, ruajtjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave në mënyrë të ligjshme, të sigurve dhe transparente, administrim efikas dhe të sigurtë i të dhënave në fushën e patentë shoferit, duke garantuar që informacioni i nevojshëm për të marrë patentë shoferin të mbahet dhe të përdoret në mënyrë të përgjegjshme dhe të ligjshme”, prandaj nga konstatimi i dhënë si më lartë Kolegji i Këshillit thekson faktin se pozita ‘**Ekzaminer**’ nuk është pozitë e njëjtë me pozitën “**Zyrtar për Administrimin e të Dhënave**”, sikurse Komisioni i Ristrukturimit ka konstatuar në Raportin e tyre të datës 03.03.2025 me rastin e propozimit për transferimin e ankuesit, ngase jo domosdoshmërisht klasa ekuivalente apo e njëjtë e bënë të njëjtë një pozitë, pasi që pozitën e dallon apo e bënë të njëjtë qëllimi i vendit të punës apo qëllimi i cili synohet të arrihet me pozitën përkatëse, kurse në rrethanat e rastit konkrete qëllim i të dy pozitave përkatëse nuk është i njëjtë, gjegjësisht pozitat “ Ekzaminer” dhe “Zyrtar për Administrimin e të Dhënave” nuk janë të njëjta, rrjedhimisht një çështje të tillë e përcakton edhe neni 16 dhe 17 i Rregullores Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil si në vijim: “**16. 1. Përshkrimi i përgjithshëm për secilën klasë në shërbimin civil të Kosovës, përcaktohet sipas Shtojcës Nr.1 të kësaj Rregulloreje. 2. Përshkrimi i përgjithshëm i punës për secilën klasë në shërbimin civil të Kosovës, sipas Shtojcës Nr. 1, përfshin: 2.1. detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të pozitave të klasës; 2.2. karakteristikat e klasës sipas faktorëve të klasifikimit; 2.3. kërkesat e përgjithshme të nevojshme për realizimin me sukses të detyrave dhe përgjegjësi të klasës; 2.4. Kërkesat e përgjithshme formale; 2.4. kriteret specifike shtesë, nëse ka; 17. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore janë ato detyra dhe përgjegjësi tipike të klasës përkatëse, apo ato tipare dalluese në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi që e dallojnë atë klasë nga një klasë në tjetër të shërbimit civil brenda kategorisë.***

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimit të ngritura nga ana e palës ankuese, se 50 pozita të tilla (Ekzaminer) apo të ngjashme, janë të lira në kuadër të Departamentit për Patentë Shofer të MMPHI-së, Kolegji i Këshillit analizoi Rregulloren (ZKM) Nr.08/2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimit të Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe konstatoi se në kuadër të Shtojcës 2 është pacaktuar edhe struktura organizative e ministrisë përkatëse, ashtu që është përcaktuar edhe Departamenti për Patentë Shofer dhe Automjete, e që në kuadër të të njëjtit departament është përcaktuar edhe Divizioni i Testimit Teorik dhe Praktik, ndërsa në kuadër të këtij divizioni janë përcaktuar 50 pozita Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidateve për Shofer, Kategoria-Profesional 1, Grupi Specialist i Administrimit të Përgjithshëm, andaj Kolegji i Këshillit me datë 02.06.2025 i është drejtuar Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MMPHI-së, më kërkesën si në vijim: “Këshilli me datë 22.05.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë për lëndën e Besim Bislimi A.nr. 7802025, mirëpo e kemi të nevojshme të kemi sqarime dhe prova shtesë: 1. Pozita “**Ekzaminer**” sipas rregullores paraprahe, më cilën prej pozita të tanishme është e njëjtë, duke marr për bazë qëllimin e vendit të punës dhe përshkrimin të detyrave kryesore të punës, 1.a) Pra a është e njëjtë me pozitën “**Zyrtar për Administrimin e të dhënave**”, apo me pozitën “**Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidateve për Shofer**”; 2. Përshkrimin e detyrave të punës dhe kriterëve të aprovuara për pozitën “**Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidateve për Shofer**”; 3. Licencat paraprahe të lëshuara për pozitat Ekzaminer, a janë të përcaktuara me validitet

kohor, dhe në rast të kalimit të validitetit, vazhdimi i tyre a ka qenë në përgjegjësi të shprehjes së interesit të nëpunësit apo është dashur të filloj sipas detyrës zyrtare procedura për vazhdimin e licencës”, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore të MMPHI-së nuk është përgjigjur në kërkesën e Këshillit, mirëpo Këshilli përmes përgjigjes së datës 18.05.2025 ka pranuar nga Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik ka pranuar përshkrimin e detyrave të punës për pozitat e aprovuara në kuadër të MMPHI-së, dhe si rrjedhojë konstatoi se përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidateve për Shofer” është si vijon: “**Detyrat Krvesore:** **“1. Kontrollimin dhe identifikimin e të dhënave të kandidatëve për shoferë, 2. Kontrollimi i dokumentacionit të automjetit; 3. Kontrollimi i dokumentacionit të instruktor shoferit nëse merr pjesë në provimin praktik; 4. Kontrollimi i pajisjeve elektronike a janë funksionale; 5. Kontrollimi i automjetit a i plotëson kushtet për mbajtjen e provimit; 6. Identifikimi i kandidatit për shoferë; 7. Udhëzimet për kriteret dhe rregullat e provimit; 8. Njoftimi lidhur me pyetjet të cilat kanë përmbajtje të paqarta apo me lëshime teknike; 9. Përgatitja e raporteve periodike mbi ecurit e testimi dhe rezultatet e provimit sipas kategorive përkatëse; 10. Punët shtesë sipas nevojës nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë; 11. Përgatitja e raportit të punës; 12. Vendosja e kamerave për testimin e kandidatëve për patentë shoferë; 13. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.”**, ndërsa **Qëllimi i përgjithshëm i pozitës së punës**, është si në vijim: “**Të sigurojë një vlerësim të drejtë dhe objektiv të aftësive dhe kompetencave të kandidatëve për patentë shofer duke përfshirë njohuritë teorike, aftësitë praktike dhe sjelljen në rrugë, në mënyrë që të sigurohet një shofer i sigurt dhe i përgjegjshëm në rrugë.**”, kurse Kërkesat e Përgjithshme Formale dhe Specifike, janë përcaktuar si në vijim: “**Grupi dhe fusha e kërkuar e arsimit:** Grupi i administrimit të përgjithshëm, Fusha: **Arsim i lartë i paspecifikuar (Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor); Përvoja:** Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës. **Kërkesat Specifike:** Nuk ka”, andaj Kolegji i Këshillit nga konstatimi i lartcekur si në arsyetimin e këtij vendimin erdhi në përfundimin se pozita Ekzaminer është pozitë e njëjtë për nga qëllimi i vendit të punës me pozitën “Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidateve për Shofer”.

Kolegji i Këshillit po ashtu analizoi edhe pjesën e Raportit të Punës të datës 03.03.2025 të Komisionit të Ristrukturimit, në faqe 18 nga 40, të titulluar Lëvizja Brenda Kategorisë si Pasojë e Risistemimi dhe konstatoi se këtij procesi sipas këtij përkufizimi i janë nënshtruar transferimit 98 zyrtar (tabela sipas Raportit të punës i datës 03.03.03.2025, nga faqe 18-24), me arsyetimin sipas komisionit përkatës, se disa pozita me rregulloren paraprake të organizmit të brendshëm kanë qenë të përcaktuar të jenë Profesional 2, ndërsa me hyrjen në fuqi të rregullores së re janë përcaktuar të jenë Profesional 1, me specifikacionin se zyrtarëve përkatës u janë analizuar dosjet personale, kualifikimet profesionale e mbi të gjitha Komisioni i ristrukturimit, thekson faktin se përparësi për transferimin në pozitat përkatëse të apostrofuara si më lartë në këtë pjesë të raportit iu është dhënë zyrtarëve të cilët kanë pasur vlerësimin më të lartë në tre (3) vitet e fundit.

Tutje Kolegji i Këshillit nga analizimi pikës së titulluar Lëvizja Brenda Kategorisë si Pasojë e Risistemimi të Raportit të Punës të datës 03.03.2025, po ashtu konstatoi se ka raste kur nëpunës civil apo thënë ndryshe sipas pozitës së punës “Depoist-Profesional 3” është transferuar në “Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidateve për Shofer-Profesional 1”, nga pozita “Asistent Administrativ-Profesional 3” është transferuar në “Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidateve për Shofer-Profesional 1”, nga pozita ‘Zyrtare Administrative në NJPSH-Profesional 3’ është transferuar në “Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidateve për Shofer-Profesional 1” dhe po ashtu nga pozita “Ekzaminer-Profesional 2” (pozita e njëjtë me pozitën që mban ankuesi) është transferuar në “Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidateve për Shofer-Profesional 1”, nga rrjedh se Komisioni i

Ristrukturimit ka vepruara më standarde të ndryshme në raport me procesin transferimit ndaj ankuesit për shkak të ristrukturimit të institucionit, për arsytet e dhëna si në vijim:

Fillimisht, Kolegji i Këshillit thekson fakti se kuadri ligjor në fuqi, respektivisht Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, askund nuk e kanë të rregulluar apo përcaktuar madje as nuk është i njohur termi apo instituti i Lëvizja Brenda Kategorisë si Pasojë e Risistemimi, ndërsa çështje e përcaktimit të kësaj kategoria, pra i Lëvizjes Brenda Kategorisë ka qenë pjesë e rregullimit ligjor sipas Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i cili më nuk është në fuqi, që nga data 25.09.2023.

Kolegji i këshillit po ashtu, konstatoi se nuk prejudikon faktin se pozitat e sipër cekura apo zyrtarët nga pozitat përkatëse, t'i kenë plotësuar apo jo kriteret e përcaktuara për tu transferuara apo sistemuar në pozitën “Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidateve për Shofer-Profesional 1”, mirëpo Komisioni përkatës i ristrukturimit është dashur të zbatojë drejtë ligjin material, respektivisht të ndjek procedurat e përcaktuara me Rregulloren Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil nga nenin 12, paragrafi 1, nenit 13, paragrafi 1, 7 dhe 8 ku përcaktohet se: “**12.1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori; 13.1. Në rastet e shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, DMZP për institucionet e administratës shtetërore, apo NjMBNj për institucionet e tjera, brenda 30 ditëve nga miratimi i aktit të ristrukturimit krijon një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, për të cilën ky i fundit i plotëson kërkesat e vendit të punës; 13.7. Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve për shkak të ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kriteret: 7.1. përvojën e nëpunësit në shërbimin civil; 7.2. mesataren e vlerësimeve të rezultateve në punë të nëpunësit për tre (3) vitet e fundit; 7.3. kualifikimet profesionale të nëpunësit; dhe 7.4. trajnimet e nëpunësit.; 13.8. Komisioni i ristrukturimit cakton peshën specifike të kriterëve të përcaktuara në paragrafin 7 të këtij neni dhe metodologjinë e vlerësimit të secilit kriter.”, pasi që pasqyrimi si në Raportin e Punës të datës 03.03.2025, e dëshmon të kundërtën, ngase Komisioni i Ristrukturimit duke marrë parasysh që ankuesi ka mbajtur pozitën e Ekzaminerit, pozitë kjo e ngjashme për nga qëllimi me pozitën Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidateve për Shofer, është dashur që i njëjti t'i nënshtrohet procesit të poentimit, sikurse procesit të poentimit është dashur t'i nënshtrohen edhe të gjithë ata nëpunësit e tjerë të cilët paraprakisht kanë mbajtur pozita të Ekzaminerit, apo pozita të ndryshme respektive e që janë transferuar në pozitën Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidateve për Shofer, duke marrë për bazë dispozitat e aplikuara nga paragrafi 1 dhe 7 të nenit 13 të Rregulloren Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ashtu që Komisioni i Ristrukturimit është dashur t'i ketë parasysh edhe verifikimin nëse kandidatët duke përfshirë edhe ankuesin, pra nëse të njëjtit i plotësojnë kriteret e aprovuara për pozitën përkatëse, poentimi nga fusha e vjetërsisë në shërbimin civil, trajnimet dhe vlerësimin e rezultateve në punë, e më pastaj të përcaktojnë në formë tabelare pikët e fituara nga procesi i poentimit për secilën fushë, për kandidatët respektiv dhe nëse eventualisht kandidati si ka plotësuar kriteret për pozitën përkatëse apo del me më pak pikë se kandidatë e tjerë, rekomandimi për sistemim në ndonjë pozitë tjetër ta arsyetojnë me shkrim, e jo sikurse komisioni përkatës i ka dhënë rëndësi vetëm fushës së vlerësimit të rezultateve të punës, ngase ky veprim bie ndesh me dispozita e nenit 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “**Menaxhimi i marrëdhënies së punës së nëpunësve/it civil, nëpunësve/it të shërbimit publik, krijuesve/it dhe performuesve/it të artit dhe kulturës, si dhe nëpunësve/it teknike dhe mbështetëse, bazohet në parimin e ligjshmërisë, integritetit, meritës, transparencës, profesionalizmit, paanësisë partiake dhe mosdiskriminimit.**”, pasi që në të njëjtën proces të ristrukturimit të institucionit përkatës, i njëjti Komision në disa raste për pozita të tjera e ka**

aplikuara procesin poentimit sipas dispozitave të aplikuara të rregullores përkatëse nga nenet e referuara si më lartë.

Nisur nga konstatimi i dhënë si më lartë, Kolegji i Këshillit mori përbazë dispozitat e aplikuara të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, nenin 7 dhe 8 ku përcaktohet se: “7. Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve për shkak të ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kritere: 7.1. përvojën e nëpunësit në shërbimin civil; 7.2. mesataren e vlerësimeve të rezultateve në punë të nëpunësit për tre (3) vitet e fundit; 7.3. kualifikimet profesionale të nëpunësit; dhe 7.4. trajnimet e nëpunësit. 8. Komisioni i ristrukturimit cakton peshën specifike të kriterëve të përcaktuara në paragrafin 7 të këtij neni dhe metodologjinë e vlerësimit të secilit kriter.” si dhe dispozitat e Udhëzuesit Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimit pas Ristrukturimit-Shtojca nr. 1 METODOLOGJIA E VLERËSIMIT DHE SISTEMI I PIKËZIMIT PËR KRITERET E VLERËSIMIT “1. Vendimmarrja e Komisionit të Ristrukturimit bazohet në një sistem pikëzimi, i cili do të mundësojë vlerësimin me pikë të kriterëve për prioritetin e transferimit, për nëpunës konkurrentë për një pozitë pune. Neni 15 i Rregullores së Transferimit ka përcaktuar kriteret e mëposhtme për vlerësimin e nëpunësve të prekur nga ristrukturim: 1.1 Vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; 1.2 Vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë ; 1.3 Kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë; dhe 1.4 Trajnimet. 2. Megjithatë, kriteret e treguara në Rregullore do të përdoren vetëm pas aplikimit të parimeve të treguara në pjesën V, pika 2 e Udhëzimit për Sistematizimin e Nëpunësve Civilë më sipër dhe vetëm për nëpunësit konkurrentë për të njëjtën pozitë pune. 3. Nga kriteret e mësipërme, “kualifikimet profesionale” dhe “trajnimet” janë pjesë e të njëjtës kategori vlerësimi dhe do të trajtohen si e tillë. 4. Lidhur me vjetërsinë (përvojën) në shërbimin civil do të dallojmë mes 3 rasteve: 4.1 Përvojës në përgjithësi në shërbimin civil; 4.2 Përvojës së punës në pozita të ngjashme në shërbimin civil me pozitën për të cilin po gjykohet. Me pozita të ngjashme kuptohen pozitat e punës me përshkrimin të përafërt dhe me arsimin të ngjashëm, (p.sh. pozita për të cilën po gjykohet është “Drejtor i Departamentit për Kërkimin Shkencor” në Ministrinë e Arsimit; pozita e ngjashme është “Drejtor për Arsimin e Lartë” në të njëjtën Ministri); 4.3 Përvojës së punës në pozitën për të cilën po gjykohet, apo në pozita të njëjta të shërbimit civil me atë për të cilin po gjykohet. Këto pozita kanë përshkrim të njëjtë pune, (p.sh. pozita për të cilën po gjykohet është “Drejtor i Departamentit të Financave” në Ministrinë e Brendshme; pozita e njëjtë është “Drejtor i Departamentit të Financave” në secilën prej Ministrive); **Rregull:** Për çdo vit përvojë në shërbimin civil, nëpunësi merr 1 pikë. Për çdo vit përvojë në pozita të ngjashme, nëpunësi merr 2 pikë. Për çdo vit përvojë në pozitë të njëjtë, nëpunësi merr 3 pikë. Për shembull, nëse një nëpunës civil ka 8 vjet përvojë punë në total në shërbimin civil, nga këto 3 vite në pozitë të ngjashme dhe 2 vite në pozitë të njëjtë ai do të marrë: $(3 \times 1) + (3 \times 2) + (2 \times 3) = 15$ pikë; 6. **Kualifikimet profesionale dhe trajnimet.** Të dy këto raste të parashikuara nga Rregullorja janë pjesë e kategorisë së aftësisimit gjatë punës. Meqenëse ende nuk ka një sistem të dhënies së kredive për trajnimet dhe kualifikimet profesionale, vlerësimi i këtyre kriterëve mbetet në dikrecionin e komisionit të ristrukturimit.”

Duke marrë përbazë dispozitat nga kuadri ligjor në fuqi, dhe aktet nënligjore që trajtojnë natyrën juridike të kësaj çështje administrative, në rrethanat e rastit konkret transferimi me rastin e ristrukturimit, Kolegji i Këshilli konstatoi se Komisioni i Ristrukturimit me rastin e zhvillimit të procedurës së ristrukturimit për transferimin e ankuesit lidhur me pozitën e punës “Zyrtar për administrimin e të dhënave” dhe nëpunësve të tjerë lidhur me transferimin e tyre në pozitën “Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidatëve për Shofer”, ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material, nuk ka ndjek qëllim legjitim kundrejt normave të aplikuara, nuk ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht nuk e ka arsyetuar rekomandimin për transferimin e ankuesit në pozitën Zyrtar për administrimin e të dhënave, sikurse nuk e ka arsyetuar as rekomandimin për transferimin e nëpunësve

të tjerë në pozitën *Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidateve për Shofer*, pozitë në të cilën ankuesi pretendon të transferohet.

Në vështrim dhe mbështetje të dispozitave të aplikuara nga neni 2 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërlidhur me nenin 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme”* dhe si rrjedhojë pjesa nga faqe 3 dhe faqe 8, RISISTEMIMI NË POZITA TË NJËJTA-tabela, në numrin rendor 85, e Raportit të Punës e që ndërlidhet me procesin e transferimit të ankuesit në pozitën *“Zyrtar për Administrativin e të Dhënave”* si dhe pjesa e tabelës me të gjitha pozitat e përcaktuara *“Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidatëve për Shofer*, nga faqe 18 deri 24, LËVIZJA BRENDA KATEGORISË SI PASOJË E RISISTEMIMIT, janë të paligjshme, ngase Komisioni i Ristrukturimit është lëshuar në shkelje thelbësore të ligjit material nga neni 66 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, neni 13 paragrafi 7 të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil dhe Udhëzuesit Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimit pas Ristrukturimit-Shtojca nr. 1 METODOLOGJIA E VLERËSIMIT DHE SISTEMI I PIKËZIMIT PËR KRITERET E VLERËSIMIT, aktit të kontestuar (Raportit të Punës Nr.191 i datës 03.03.2025) i mungon arsyetimi, gjegjësisht nuk ka shpjegim të arsyeshëm ligjor mbi konstatimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, nuk janë përcaktuar shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave dhe as nuk ka përcaktuar bazën ligjore të rekomandimit dhe arsyeën pse është i zbatueshëm në rrethanat e rastit konkret.

Prandaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë lidhur me paligjshmërinë e akteve të kontestuara, dhe me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, e në mbështetje të nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit mori vendim që të anuloi Vendimin Nr.392 të datës 18.03.2025 e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB përmes të cilit ankuesi ishte transferuara në pozitën *Zyrtar për Administrativin e të Dhënave* në kuadër të MMPHI-së, po ashtu anulohet Numrin rendor 78, në faqen 8-tabela, nga (RISISTEMIMI NË POZITA TË NJËJTA, faqe 3), e që ndërlidhet me procesin e transferimit të ankuesit në pozitën *“Zyrtar për Administrativin e të Dhënave”* si dhe po ashtu anulohet tabela lidhur me të gjitha pozitat e përcaktuara të transferimit *“Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidatëve për Shofer*, nga faqe 18 deri 24, LËVIZJA BRENDA KATEGORISË SI PASOJË E RISISTEMIMIT, e Raportit të Punës të datës 03.03.2025 të Komisionit të Ristrukturimit, sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ndërsa ankesën e ankuesit 30.04.2025 dhe pretendimet e tij i shpalli si të bazuara, kurse lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni i Ristrukturimit për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, duke ndjekur pikëpamjet e dhëna juridike si në këtë vendim, ashtu që ankuesi t'i nënshtrohet procesit të poentimit së bashku me kandidatët e tjerë për pozitën *“Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidatëve për Shofer”*.

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit thekson faktin se procedura e ristrukturimit për pozitën të cilës i është nënshtruar ankuesi duk u transferuar në pozitën *Zyrtar për administrimin e të dhënave* është zhvilluar në kundërshtim me parimet e përgjithshme të Shërbimit Civil të përcaktuar si ne nenin 8 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe neni 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj Komisioni i Ristrukturimit me rastin e rishqyrtimit të procedurës së ankuesit për poentim kundrejt kandidatëve të tjerë në procedurë për pozitën *“Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Kandidateve për Shofer”* duhet të marrë parasysh pikëpamjet e dhëna juridike

si në arsyetimin e këtij vendimi, të ketë po ashtu parasysh zbatimin e drejtë të ligjit material dhe legjislacionit sekondar që derivon nga ligji bazik për shërbimin civil dhe mes tjerash të ketë parasysh detyrimet e përcaktuara si në nenin 28 paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “1. Zyrtarja/i publik ka për detyrim të respektojë Kushtetutën, ligjin dhe ka për detyrim të mbroj interesin publik dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. 2. Zyrtarja/i publik ushtron detyrat e saj/tij dhe vepron me profesionalizëm, paanësi, mosdiskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe kodin e etikës.”, ndërlidhur me nenin 55 dhe 56 paragrafi 4, nën paragrafi 4.5 i të njëjti ligj.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 4 dhe 5 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.780/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit B.B;
- Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (*Sekretarit të Përgjithshëm, Komisionit të Ristrukturimit dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore*),
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.